



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 7 dt. 10.03.2014

Në mbështetje të nenit 28, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 10.03.2014, pasi shqyrtoi dokumentacionin mbi propozimet për shpalljen e zonave të mbrojtura dhe monumente kulture të diskutuara në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. T’i propozojë Ministrit të Kulturës,
 1. Shpalljen monument kulture të “Fortifikim i një banese feudale” në rrugën Thoma Kalefi, Elbasan.
 2. Shpalljen ansambël historik “Parku Geraldinë”, në qytetin e Burrelit.
 3. Shpalljen e zonës së mbrojtur për rrënojat e kishës së Çiflikut, Sarandë.
 4. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Kalanë e Dorëzit.
 5. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Kalanë e Këlcyrës.
 6. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Qytetin në Triport, (Aulonë), Vlorë
 7. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Kalanë e Kaninës, Vlorë
 8. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Porto Palermon, Himarë, Vlorë
 9. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Kishën e Ipapandisë, Dhërmi, Vlorë.
 10. Shpalljen e zonës së mbrojtur për Kishën e Shën Stefanit, Dhërmi, Vlorë.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI